



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 6614 Prot.

Fier, më 22.05.2026

Projekt - Vendim

Nr. 53 dt. 22.05.2026

“Për dhënien e mendimit/dakordësisë në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës publike, pasurisë nr. 3/399 zk. 8534 (e llojit lulishte), me sipërfaqje totale 3 702 m², lagja “Apolonia” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .05.2026, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave, bazuar në nenit 9 pika 1.2, neni 23 pika 9, neni 54, shkronja “e/1” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 801-825 të K.Civil, VKM nr. 574 dt. 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, Qarku Fier” i ndryshuar, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 109 dt. 27.11.2025 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

1. Dhënien e mendimit/dakordësisë në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës publike, pasurisë nr. 3/399 zk. 8534 (e llojit lulishte), me sipërfaqje totale 3 702 m², lagja “Apolonia” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier”, dhënien në administrim një subjekti privat të kësaj sipërfaqje nëpërmjet kryerjes së procedurave administrative – ligjore sipas legjislacionit në fuqi **apo** administrimin publik të kësaj pasurie nga Bashkia Fier.
2. Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore sipas përcaktimeve ligjore.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave
Drejtor: M. Petushi

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Drejtor: F. Troka

Drejtoria e Kontabilizimit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat
Drejtor: E. QOKU

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejtor: P. Çina

Drejtoria Juridike
Drejtor: E. Kapllanaj

Sekretar i Përgjithshëm
Nikollaq Nçyp

KRYETARI
Armando SUBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË PRONAVE

Nr. 6614/Prot.

Fier, më 22.05.2026

RELACION

“Për dhënien e mendimit/dakordësisë në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës publike, pasurisë nr. 3/399 zk. 8534 (e llojit lulishte), me sipërfaqje totale 3 702 m², lagja “Apolonia” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier”

Të nderuar Znj. Z. Këshilltarë!

Bashkia Fier ka në pronësi pasurinë nr. 3/399 zk. 8534, e llojit “lulishte” me sipërfaqje totale 3 702 m², ndodhur në lagjen “Apolonia” Fier, paisur me Çertifikatën e pronësisë me Kodin unik 1480121.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 53 dt. 19.06.2015 “Për shfrytëzimin e një sipërfaqje prej 100 m²”, është miratuar kërkesa e shtetasit Nimet Kamberaj për shfrytëzimin e një sipërfaqje prej 100 m² tek lulishtja pranë shatërvanit për një periudhë 5 vjeçare.

Në dt. 09.12.2019 është lidhur akt marrëveshja nr. 0046 ndërmjet Bashkisë Fier dhe investitorit subjektit fizik Nimet Kamberaj me objekt “*Rikonstruksioni i lulishtes pranë shatërvanit në qytetin e Fierit sipas projektit të miratuar me vendimin nr. 3 dt. 29.09.2011 të K.RRT - së Bashkisë Fier dhe preventivit shoqërues në një sipërfaqje sheshi prej 4795 m².*”

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 107 dt. 28.12.2020 “Për shfrytëzimin e një sipërfaqje prej 100 m²”, është miratuar kërkesa e shtetasit Nimet Kamberaj për shfrytëzimin e lulishtes pranë shatërvanit me sipërfaqje prej 100 m² dhe mirëmbajtjen e saj për një periudhë 5 vjeçare.

Mbi bazën e këtij vendimi është vijuar me lidhjen e akt - marrëveshjes nr. 10151/1 prot. dt. 19.02.2021 ndërmjet Bashkisë Fier dhe shtetasit Nimet Kamberaj me cilësinë e huamarrësit, me objekt “*Dhënie në përdorim të PF Nimet Kamberaj nga Bashkia Fier të një sipërfaqje prej 100 m² pranë lulishtes te shatërvani në lagjen “Apolonia”, pasuria nr. 3/399 zk. 8534, sipërfaqje e cila do të përdoret nga subjekti huamarrës si ambjent me qëllim zhvillimin e aktivitetit ekonomik bar – kafe, me elementë të çmontueshëm si dhe 20 m² të inkorporuara në objekt, të cilat do të përdoren si banjo publike në funksion të komunitetit, ambjent i cili do të ndërtohet dhe mirëmbahet nga subjekti huamarrës si dhe mirëmbajtje dhe përkujdesje të lulishtes me sipërfaqje 3 702 m²”*. Kjo sipërfaqje është dhënë me huapërdorje pa kundërshtpërblim.

Nga informacioni i marrë me shkresën nr. 4960/1 prot. dt. 21.04.2026 të Drejtorisë së Përgjithshme të të Ardhurave, Sektori i vlerësimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat është paraqitur informacioni se subjekti pf. Nimet Kamberaj me Nipt K92616401P ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për periudhën kohore deri në Dhjetor 2025. Me përfundimin e afatit kohor 5 vjeçar të akt - marrëveshjes nr. 10151/1 prot. dt. 19.02.2021, duke ju referuar përcaktimeve ligjore të parashkuara, nëpërmjet shkresës nr. 1806 prot. dt. 09.02.2026 me lëndë “Njoftim për lirimin e ambjenteve” drejtuar z.

Nimet Kamberaj, nga ana e Bashkisë është kërkuar marrja e masave për zhvendosjen e strukturës metalike të çmontueshme e përdorur për zhvillimin e aktivitetit ekonomik bar – kafe dhe lirim të sipërfaqes së përdorur sipas akt - marrëveshjes.

Nga ana e z. Nimet Kamberaj është paraqitur kërkesa nr. 1 prot. dt. 12.02.2026 e protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 2692 prot. dt. 27.02.2026 me anë të të cilës ka kërkuar rinovimin e akt marrëveshjes, duke marrë përsipër mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e gjithë sipërfaqes së lulishtes përfshirë edhe tualetet publike të ndodhura në këtë sipërfaqje.

Me përfundimin e procedurave administrative, Bashkisë Fier si autoriteti publik përgjegjës i lind e drejta për mirëadministrimin e pronës dhe sistemimin e lulishtes duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, drejtpërdrejt ose përmes dhënies në administrim një subjekti privat. Në rast të vendimmarrjes nga ana e Këshillit Bashkiak për dhënien në administrim të një subjekti privat, nga ana e ekzekutivit do të vijohet me procedurat administrative – ligjore për përcaktimin e kushteve të akt – marrëveshjes/kontratës, e cila do të parashtrohet përsëri Këshillit Bashkiak për vendimmarrje.

Përsa më sipër, në bazë të nenit 9 pika 1.2, neni 23 pika 9, neni 54, shkronja “e/1” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 801-825 të K.Civil, VKM nr. 574 dt. 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, Qarku Fier” i ndryshuar, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 109 dt. 27.11.2025 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, i paraqesim materialin mbi miratimin e kërkesës nga Këshilli i Bashkisë Fier për:

- Dhënien e mendimit/dakordësisë në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës publike, pasurisë nr. 3/399 zk. 8534 (e llojit lulishte), me sipërfaqje totale 3 702 m², lagja “Apolonia” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier”, dhënien në administrim një subjekti privat të kësaj sipërfaqje nëpërmjet kryerjes së procedurave administrative – ligjore sipas legjislacionit në fuqi apo administrimin publik të kësaj pasurie nga Bashkia Fier.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave Publike
Konc. M. Petushi

Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Drejtori: F. Troka

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejtori: P. Çina

Drejtoria e Kontabilizimit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat

Drejtori: E. Qoku

Sekretar i Përgjithshëm
Nikollag Neço



Adresa: Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15 Fier - SHQIPËRI Tel. + 355 34 410650, www.bashkiafier.gov.al